

**Tirane, me 26 Mars 2021**

**Shenime shpjeguese**

- *Informacion i pergjithshem dhe politikat kontabel.*

Shoqeria tregetare "ANNA-TOURS INTERLINES" shpk, ushtron aktivitet ne baze te rregjistrimit ne Degen e Tatimeve me NIPT J81809003U.

Aktiviteti kryesor eshte "Transport nderkombetar me autobus, tregeti te mallrave industrial, etj", e cila ushtrohet ne adresen Bulevardi "Zogu i I-re", Nr.54, Tirane, qe eshte dhe adresa kryesore e subjektit.

Gjate pergatitjes se pasqyrave financiare jane mbajtur parasysh politikat kotabel:

a) Hartimi i Pasqurave Financiare eshte mbeshtetur ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

b) Pasqyrat financiare jane ndertuar mbi bazen e te dhenave te rregjistrimeve kontabel dhe evidencave, te perpiluara paraprakisht mbeshtetur ne dokumentacionet e perpiluara dhe te pranuar nga subjekti.

c) Aktivitetet, pasivet dhe kapitali jane paraqitur ne pasqyrat financiare me llogari te vecanta, mbasi jane dokumentuar dhe inventarizuar nga subjekti pergjegjes.

d) Ne kontabilizimin, dokumentimin dhe pergatitjen e pasqyrave financiare te vitit 2020 jane mbajtur si baze dhe ne vijimesi pasqyrat financiare te vitit 2019.

Gjate mbajtjes dhe rregjistrimeve kontabel te vitit 2020, si dhe perpilimit te pasqyrave financiare te vitit 2020 jane ndjekur te njejtat politika kontabel te zbatuara gjate vitit 2019.

a) Rregjistrimi i aktiveve dhe pasiveve eshte bere sipas metodes historike.

b) Mbajtja dhe vleresimi kontabel i Inventarit eshte bere sipas metodes se mesatares se ponderuar.

c) Mbajtja dhe vleresimi i vleres kontabel te AQT eshte bere sipas metodes se koston historike, dhe perben vleren kontabile neto.

d) Ne perllogaritjen e vleres se amortizimit te AQT eshte zbatuar metoda e amortizimit sipas normave te sistemit fiskal te RSH.

e) Kerkesat dhe Detyrimet jane te rregjistruara, ne daten e lindjes se tyre, per vleren nominale te rimbursimit, sipas parimit te koston historike.

f) Ne perllogaritjen e Rezultatit ushtrimor eshte mbajtur parasysh parimi i kujdesit, ne kuptimin qe te ardhurat dhe shpenzimet e ushtrimit ti perkasin te njejtit vit ushtrimor, si dhe te kene qellim te njejte.

- *Shpjegimi i zerave te pasqyrave financiare*

**1. Bilanci kontabel date 01.01.2020 - 31.12.2020**

**AKTIVET**

**I. Aktivet afatshkurtra**

1- Aktive monetare, ne vleren 1,813,898 leke, e cila perfshin:

- gjendjet ne llogarite bankare ne shumen 1,813,898 leke.

3(i)- Kerkesa te arketueshme, ne vleren 97,559,576 leke, e cila perfshin gjendjen e klienteve te paarketuar.

3(ii)- Kerkesa te tjera te arketueshme, ne vleren 16,377,138 leke, e cila perfshin:

- gjendja TVSH-kreditore, ne masen 16,076,008 leke, me 31.12.2020.

- gjendja Tatim Fitimit derdhur teper, ne masen 301,130 leke, me 31.12.2020.

4(i)- Inventar, ne vleren 248,700 leke, e cila perfshin gjendjen ne magazine te:

- Materiale dhe Bileta te transportit nderkombetar te pashitura, ne shumen 248,700 leke.

**II. Aktivet afatgjata**

2(iii)- Makineri dhe pajisje (me vlere kontabile), ne vleren 52,551,271 leke, e cila perfshin vleren kontabile neto te AQT, per vleren e rivleresuar reale te automjeteve ne perdorim, etj, qe subjekti ka ne perdorim.

**DETYRIMET DHE KAPITALI**

**I. Detyrimet afatshkurtra:**

2(i)- Hua dhe obligacione, ne vleren 21,418,421 leke, e cila perfshin vleren e kredise te marre prane bankes BTK dhe Alpha Bank per blerje AQT.

3(i)- Te pagueshme ndaj furnitoreve, ne vleren 8,125,428 leke, e cila perfshin vleren e furniturave per sherbime e mallra te papaguara.

3(ii)- Te pagueshme ndaj punonjesve, ne vleren 3,428,981 leke, e cila perfshin shumen e papaguar ndaj punonjesve per paga dhe dieta, deri me 31.12.2020.

3(iii)- Detyrime tatimore, ne vleren 51,042 leke, e cila perfshin gjendjen e detyrimeve tatimore,

- Shteti-Sigurime shoqerore e shendetesore ne vleren 41,292 leke,

- Shteti-Tatimi ne Burim ne vleren 9,750 leke.

3(iv)- Hua te tjera, ne vleren 120,219,566 leke, e cila perbehet nga :

- Huaja e dhene ne mjete monetare nga ortaku i shoqerise per perballimin e likuiditetit te detyrimeve afatshkurtra te shoqerise, dhe blerjeve te AQ te shoqerise.

**III. KAPITALI**

3. Kapitali aksionar, ne vleren 100,000 leke,

Perfshin vleren e kontributit te derdhur per krijimin e shoqerise.

9. Fitimet e mbartura nga vitet e kaluara ushtrimore, ne vleren 14,836,122 leke, e cila perfshin vleren neto te fitimit te pashperndare.

10. Fitimi i vitit ushtrimor financiar, ne vleren 371,023 leke, i cili perfshin vleren e fitimit neto te vitit ushtrimor 2020.

## **2. Pasqyra te ardhurave e shpenzimeve periudha 01.01.2020 – 31.12.2020**

1. Shitjet neto, ne vleren 8,842,595 leke, e cila perfshin vleren e sherbimeve te shitura.
  4. Materialet dhe mallrat e konsumuara dhe te shitura, ne vleren 4,183,422 leke, e cila perfshin vleren e blerjeve per materialet e perdorura gjate procesit te kryerjes se sherbimeve:
    - Lende djegese (karburante), materiale,shp.siguracioni autobuzesh, etj,
  5. Kosto e punes, ne vleren 2,824,140 leke, e cila perfshin pagat e punonjesve ne masen 2,420,000 leke dhe shpenzimet per sigurimet shoqerore-shendetesore te perballuara nga punedhenesi ne masen 404,140 leke.
  7. Shpenzime te tjera, ne masen 1,540,315 leke, e cila perfshin shpenzimet kryesore te aktivitetit si:
    - Shpenzime per qera ambientesh ushtrimi aktiviteti ne vleren 1,095,000 leke,
    - Shpenzime per taksa, parkime dhe tarifa vendore ne vleren 203,500 leke,
    - Shpenzime per dieta ne masen 210,000 leke,
    - Shpenzime komisione bankare, etj, ne masen 32,315 leke, etj.
  - 8.Totali i shpenzimeve, ne vleren 1,540,315 leke,
    - Perfshin totalin e shpenzimeve nga zeri 4-7.
  9. Fitimi nga veprimtaria kryesore, ne vleren 294,718 leke,
    - Perfshin rezutatit ndermjet te ardhurave nga kryerja e sherbimeve, me totalin e shpenzimeve.
- 12.2 Shpenzime nga interesi, perfshin shpenzimet financiare per pagesen e shpenzimeve per interest e kredise te marre prane BKT dhe Alpha Bank, ne vleren 154,167 leke.
- 12.4 Te ardhura te tjera financiare, ne te cilen perfshihen te ardhurat e perfituara nga shoqerite e sigurimeve per kompesimin ne vlere te demeve te shkaktuara nga aksidentet, ne vleren 250,000 leke.
  - 13 Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare eshte ne vleren 95,833 leke.
  14. Fitimi para tatimit eshte ne masen 390,551 leke.
  15. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin, jane ne masen 19,528 leke, e cila perfshin 5% te vleres se tatimit te fitimit te perlllogaritur nga shuma e fitimit para tatimit.
  16. Fitimi neto i vitit financiar eshte ne masen 371,023 leke.

## **3. Pasqyra levizjeve ne kapitalet e veta per periudhen 01.01.2020 - 31.12.2020**

Pasqyra e levizjeve te kapitaleve te veta paraqet:

Pozicionin me date 31.12,2019,...

Kapitali aksionar, ne masen 100,000 leke,

Fitimi i vitit ushtrimor 2019, ne masen 14,836,122 leke,

Totali, i kapitaleve te veta 14,936,122 leke.

Gjate vitit 2020, kapitali shtohet me fitimin e periudhes kontabel, ne masen 371,123 leke.

Pozicionin me date 31.12,2020,...

Kapitali aksionar ne masen 100,000 leke,

Fitimi i neto i periudhes, ne masen 15,207,145 leke,  
Totali, i kapitaleve te veta, ne fund te periudhes 15,307,145 leke.

#### **4. Pasqyra e flukseve te parase per periudhen 01.01.2020 - 31.12.2020**

Fluksi i parave te aktivitetit ekonomik ne shoqerine "ANNA-TOURS INTERLINES" shpk eshte pasqyruar ndermjet metodes indirekte.

Paraja neto nga aktivitetet e shfrytezimit eshte pakesuar me 3,656,213 leke, e cila eshte rezultat:

- Fitimi para tatimit i vitit 2020 ... 390,551 leke,
- Ritja e teprices se kerkesave te arketueshme nga aktiviteti, si dhe kerkesave te arketueshme te tjera ne masen - 182,899 leke,
- Pakesimi i inventarit ne masen 398,348 leke,
- Pakesimi i teprices se detyrimeve per tu paguar nga aktiviteti ne masen 958,872 leke.

- Tatim fitimi i paguar per rezultatin e vitit 2019 eshte ne masen - 19,528 leke.

- Blerje e AQT-ve eshte ne masen 3,283,813 leke.

Rezultantja e faktoreve te mesiperm eshte pakesimi i mjeteve monetare te subjektit ne shumen 3,656,213 leke.

**ADMINISTRATOR**

Diela PREKA

